

**PAI**





**PAI**

**Partia e Ashkalinjëve për Integrim**

**STATUTI**

**13.Maj .2018**

# **Partia e Ashkalinjëve për Integrim**

# **STATUTI**

**13.Maj .2018**

**Konform Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve me Nr.03 L -073, Nr.03 L-256, Nr.04 L-058, Nr.04 L-212, dhe bazuar në rregulloren e KQZ-së me Nr.01/2013 ,Regjistrimi dhe veprimi i partive politike në Republikën e Kosovës.**

## **Statuti**

**Partia e Ashkalinjëve për Integrim**

# **I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

## **Neni 1**

1.1 Partia Ashkalinjëve për Integrim është parti politike e qytetarëve të lirë, e cila aktivitetin e vet politik e zhvillon në bazë të statutit, programit dhe akteve të tjera.

## **Neni 2**

2.1 Emri i partisë është : PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM

2.2 Shkurtesa ( Akronimi ) i partisë është: PAI

## **Neni 3**

3.1 PAI vepron në mënyrë të pavarur, në territorin e Republikës së Kosovës,

3.2 PAI organizohet, dhe ka drejtë të shtrihet në diasporë dhe në vendet tjera.

3.3 PAI selin qendrorë të saj e ka në Komunën Lipjan-it, Republikën e Kosovës.

3.4 PAI ka cilësinë e personit juridik.

## **Neni 4**

4.1 PAI ka logon, flamurin, të cilat i përcakton Këshilli i Përgjithshëm.

4.2 Logo e PAI-së është : STIROLAPSI me ngjyrë ari dhe të zezë.

4.3 Flamuri i PAI-së është katror me dimension 120 x 80 cm.

4.4 Flamuri i PAI-së në mes të tij ka logon e PAI-së dhe shkronjat PAI, ndërsa flamuri ka ngjyrë të baFRhë.

4.5 PAI ka vulen e saj, në formën rrethi dhe atë katrorë për protokol.

4.6 Vula e partisë rrethore ka diametër 3 cm, në të cilën është e shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze, është I shkruar emri I plotë I partisë, selia e saj, ndërsa në mbrendi është e vendosur logo e partisë.

4.7 Vula katrore ka diametër 6 x 3 cm, është i shkruar emri i partisë në gjuhën shqipe, angleze, selia e saj, vendi për datë, dhe numër të protokolit, ndërsa në pjesën e këndit të majt qendron logo e partisë.

4.8 PAI ka llogarin rrjedhëse bankare të saj, poashtu edhe degët e saj, mundë të hapin llogarit e tyre bankare.

4.9 Llogarin bankare të PAI-së në nivel qendror ka të drejtë të ketë qasje Kryetari i PAI-së dhe Arkatari i saj me autorizim të Kryetarit.

4.10 Llogarin bankare të degës të PAI-së, ka qasje Kryetari i degës dhe arkatari i degës me autorizim të Kryetarit të degës.

## **II. TË DREJTAT DHE DETYRAT**

### **Neni 5**

5.1 Mënyra e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve si dhe statuti i anëtarëve të nderit rregullohet me rregullore dhe vendim të veçantë.

5.2. anëtarët kanë të drejtë:

- Marrin pjesë dhe angazhohen në aktivitetin e partisë.
- Zgjedhin dhe zgjidhen në organet e partisë.
- Informohen për aktivitete dhe veprime të partisë.
- Japin propozime, vërejtje dhe sugjerime në organet e partisë.
- Duhet të jenë të informuar me dokumentet e aprovuara nga organet e partisë.
- Të ruajn nderin, dinjitetin dhe interes të partisë.
- Të paguajn anëtarësin, kurse janë të liruar nga pagesa e anëtarësisë kategorit sociale.
- Anëtarët mbajn përgjegjësi politike nëse me punën dhe veprimin e vet, janë në kundërshtim me statutin, rregulloren, vendimet dhe programet e partisë.

## **III. ANËTARSIMI NË PARTI, DHE PUSHIMI NGA ANËTARSIA**

### **Neni 6**

6.1 Anëtarësimi në parti është i lirë dhe vullnetarë.

6.2 PAI është e hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim race, gjinie, relegjioni dhe etnie.

6.3 Duhet të jetë mbi moshën 18 vjeqare, respektoj statutin, rregullorën, dhe vendimet e PAI-së, dhe duhet të plotëson fletë-regjistrimin për anëtarësim në parti.

6.4 PAI mundë të ketë anëtarë nderi, me propozimin dhe miratimin e këshillit të përgjithëshëm.

6.5 Anëtarësimi në parti realizohet pranë organit më të afërt të vendit ku jeton personi, anëtarësimi realizohet në Aktive, Nëndegët, dhe Degët e partisë.

6.6 Anëtar nderi të PAI-së shpallen të gjithë individët që kanë dhënë kontribut të veçantë në realizimin e qëllimeve dhe përcaktimeve programore të partisë.

### **Neni 7**

7.1 Anëtarësimi pushon me tërheqjen e flet-anëtarësimi, përmes deklaratës së posaqshme ( Dorëheqje ) në mënyr vullnetare.

7.2 Anëtarësimi pushon me mos pagesën e anëtarësisë së rregull vjetore.

7.3 Anëtarësimi pushon me humbjen e aftësis psiko-fizike për veprim politik.

7.4. Anëtarësimi pushon me prijashtim nga rradhët e partisë, me vendim të organeve PAI.

7.5 Anëtarësimi pushon me rastin e vdekjes .

7.6 Anëtari prijashetohet nga partia kur shkel statutin, rregulloren, programin dhe vendimet e partisë, dhe kur bënë keqpërfundime të mjeteve financiare të subketit politik.

7.7 Anëtari prijashetohet nga partia, me rastin e veprimeve të pamoralshme që domtojnë prestigjin e partisë.

## **Neni 8**

8.1 Përsoni i përjashtuar ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve pas marrjes së vendimit nga organet e PAI-së për përjashtim.

8.2 Ankesën mbi vendimin për përjashtim e drejton në organet e PAI-së dhe e shqyrton këshilli i përgjithëshëm, në afat prej 15 ditëve.

## **IV. QELLIMET DHE DETYRAT E PAI-së**

### **Neni 9**

9.1 PAI si subjekt politik, ka për qëllim të realizojë Misionin, Vizionin dhe programin e saj, konform kushtetutës, ligjeve dhe normave të tjera juridike të Republikës së Kosovës.

9.2 PAI angazhohet:

- Ruajtjen e integritetit territorial dhe sovranitetit të Kosovës.
- Përfundimin e punëve demokratike gjatë veprimit politik.
- Shtet multietnik, në të cilin të gjithë qytetarët të ndjehen të lirë dhe të barabartë.
- Kosova shtet stabilë, si interes i të gjithë qytetarëve dhe si interes paqësor, në rajon dhe europë.
- Integrim i Kosovës në strukturat Euro-atlantike dhe në Nato.
- Sistem bashkëkohorë ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut dhe konkurrencës lojale, që do të rriste mirëqenjen e qytetarëve të Kosovës.
- Sistem funksional social, që do të mundësonte një jetë dinjitoze për të gjithë.
- Masa institucionale për mbrotjen e ambientit jetësor.
- Zhvillim të vlerave kulturore të cilat promovojnë komunikim multikulturor.
- Arsimit cilësor dhe të bazuar në parimet e profesionalizmit
- Zhvillimin dhe avancimin e pozitës së femrës në nivelet e vendimarrjes.
- Krijimi i kushteve për pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitete sportive – kulturore.

## **V. ORGANIZIMI I PAI-së**

### **Neni 10**

10.1 PAI, për realizimin e qëllimeve programore vepron në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe me degët e saj në Diasporë.

10.2 PAI, organizohet sipas parimit territorial.

10.3 Puna dhe veprimtaria e PAI-së, është publike për të gjithë qytetarët.

10.4. Anëtarësia e PAI-së organizohet në këto forma të organizimit:

- Organizimi vendor – Aktivitet

- Organizimi në nivel bashkesive lokale - Nëndega
- Organizimi komunal – Dega
- Organizimi në nivel nacional - Qendror

## **Neni 11**

### **Organizimi Vendor – AKTIVI**

- 11.1 Njësia themolore organizative e PAI-së është këshilli vendor- Aktivet.  
Vendimin për themelimin e këshillit vendor – Aktivet e sjellë kryesia e degës së PAI-së, në sajat të iniciativës dhe kërkesës nga anëtarët e PAI-së,të parcaktura me statutin e PAI-së.
- 11.2 Këshilli vendor – Aktivet debaton për çështje të rëndësishme dhe në interes për këshillin si dhe zabton vendimet dhe qendrimet e nëndegës dhe degës të cilës i përkasin.
- 11.3 Anëtarët e këshillit vendor – Aktivet, në mbledhjet zgjedhore,zhgjidhen me pjesëmarrjen e shumicës së anëtarëve, me shumicë votash zgjedhin Kryetarin e këshillit, numri i anëtarëve për të krijuar një aktivë është 15 pjesëmarrës, Këshilli vendor aktiviteti duhet të zgjedhë një Kryetar, Sekretarë dhe Arkatarë.
- 11.4 Mandati i kryesisë të Aktivitetit është 4 vjeçarë nga momenti i zgjedhjes së tyre, kryesia e Aktivitetit i përgjegjet dhe raporton kryesisë së degës.
- 11.5 Kryetari i aktivitetit udhëheq mbledhjet e kryesisë dhe është përgjegjës për veprimet politike mbrenda PAI-së të aktivitetit.
- 11.6 Mandati i këshillit vendor aktivitetit pushon me dorëheqjen e tyre vullnetare, ose me shkarkimin nga Kryesia e degës.
- 11.7 Nënkryetari e zavëndëson kryetarin në rastë mungese dhe e kryen punën të cilin ja beson kryetari i aktivitetit .
- 11.8. Sekretari bën pregaditjen dhe organizimin e mbledhjeve,kryen punët administrative të aktivitetit, si dhe kryen punët e tjera të cilat ja beson kryetari i aktivitetit.
- 11.9 Arkatari kujdeset dhe mban evidencën për grumbullimin e anëtarësis, dhe kryen punët financiare, po ashtu kryen punët tjera që ja beson kryetari i aktivitetit.
- 11.10 Raportet e aktivitetit dhe anëtarëve të kryesisë së aktivitetit, janë 3 mujore,6 mujore dhe 12 mujore, të cilat i drejtohen kryesisë të aktivitetit, degës dhe këshillit përgjithëshum në nivel dege.

## **Neni 12**

### **Organizimi në nivel bashkësive lokale – NËNDEGA**

- 12.1 Nëndega është njësi e organizimit territorial të PAI-së, që përfshin dy ose më tepër këshilla vendor ( Aktive) në territorin e një bashkësie lokale .
- 12.2 Vendimin për themelimin e një nëndege sjellë, Kryesia e Degës,Kryetari i degës të PAI-së në nivel dege, në saje të iniciativës dhe kërkesës së anëtarëve të PAI-së, të cilit jetojnë në territorin e dy osë më tepër aktive.
- 12.3 Organet e nëndegës janë:
  - Kuvendi i nëndegës .
  - Këshilli i përgjithëshum i nëndegës.
  - Kryetari i nëndegës .

- Kryesia e nëndegës .

- 12.4 Kuvendi i nëndegës është organi më i lartë në kuadër të drejtave dhe obligimeve të nëndegës, kuvendi i nëndegës duhet të ketë 21 anëtarë të pranishum në kuvend dhe zgjedhë Këshillin e përgjithëshëm 9 -11 anëtarëve të nëndegës dhe kryësin e nëndegës prej 5 - 7 anëtarëve.
- 12.5 Kuvendi i nëndegës ftohet sipas nevojës, por jo ma pak se një herë në vitë, thirrja e kuvendit me vendim të kryesis së nëndegës, dhe raportohet për punën një vjeqare. të kryesisë së nëndegës dhe këshillit të saj .
- 12.6 Nnëdega dhe anëtarët e saj pushojn nga detyra, në rastë të dorë-heqjes vullnetare nga anëtarët e saj, ose me shkarimin nga kryesia e degës.
- 12.7 Të gjithë anëtarët e këshillit përgjithëshëm dhe kryesisë të nëndegës Zgjedhen nga kuvendi i nëndegës me mandate prej 48 muajve .
- 12.8 Nëndega obligohet dhe ka për detyr të respektoj vendimet e kryetarit dhe kryeisë së degës në territorin të cilin vepron.
- 12.9 Nëndega gjitha vendimet në organet e saj, duhet të merr me shumicë votash nga anëtarët që prezentojn në mbledhje, duhet të jenë gjithë 50% plus + 1 anëtarë.
- 12.10 Kompetencat e nëndegës janë:
  - Realizon përcaktimet programore të PAI-së.
  - Miraton propozim-planet për të aFRhurat dhe shpenzimet, si dhe planet dhe programet për punën vjetore, pregadit raportet për punë vjetore.
  - Zhvillon aktivitetin e saj politik, në kuadër të statutit dhe programit të PAI-së, po ashtu për punën e saj i raporton degës në nivel komunal.

## **Neni 13**

### **Organizimi Komunal - DEGA**

- 13.1 Dega është njësi e organizimit më të gjër territorial të PAI-së, që përfshin territorin e një komune.
- 13.2 Vendimin për themelimin e degëve e sjell kryesia qendrore e PAI-së.
- 13.3 Dega Formohet në saje të iniciativës dhe kërkesës së anëtarëve të PAI-së nga komuna , me të cilit jetojnë në territorin për të cilin propozohet themelimi i degës që përmbush kriterret e një formimi të një dege.

## **Neni 14**

14.1 organet e degës janë:

- Kuvendi i degës.
- Këshilli i Përgjithëshëm .
- Kryetari i degës.
- Kryesia e degës.
- Forumi i gruas.
- Forumi Rinorë.

## **Neni 15**



## **Kuvendi i Degës dhe kompetencat e tij**

- 15.1 Kuvendi i degës është organi më i lartë në kuadër të drejtave dhe obligimeve të degës. Kuvendi i degës nuk duhet të ketë më pak 51 Anëtarëve prezent mbi moshën 18 vjeqare.
- 15.2 Kuvendi i degës zgjedhë, Këshillin e përgjithëshum.
- 15.3 Kuvendi i degës zgjedhë Kryetarin e degës .
- 15.4 Kuvendi i degës çdo organ të degës të cilin e zgjedhë, ka mandate për 48 muaj.
- 15.5 Kuvendi i degës ftohet nga kryetari i degës ose me shumicën e nënshkrimeve të anëtarëve të këshillit të përgjithëshum të degës.
- 15.6 Në kuvendin e degës kanë të drejtë vote të gjithë anëtarët e ftuar me shkrim,dhe vendimet merren me shumicën e votave prezent 50% plus + 1.
- 15.7 Në Kuvendin e degës raportohet për punën e Këshillit të përgjithëshum,Kryetarit dhe kryesisë, dhe del në votim raporti.
- 15.8 Pjesëmarrja e anëtarëve ( Delegatëve) në kuvendin e degës bëhet me vendim të këshillit përgjithëshum të degës, ku duhet të përfshihen të gjitha nëndegët .
- 15.9 Kuvendin e degës e udhëheq Kryesia e punës e cila zgjidhet nga anëtarët prezent.

## **Neni 16**

### **Këshilli i përgjithëshëm i degës**

- 16.1. Këshilli i përgjithëshëm është organi më i lartë i PAI-së në mes të dy kuvendeve.
- 16.2 Këshilli i përgjithëshum zgjedhet nga Kuvendi i degës, dhe numri i tij është 15- 21 anëtarë në degë, duke përfshi në përbërjen e tij, edhe pjestarë të forumit rinor dhe forumit gruas.
- 16.3 Puna dhe funksionimi i Këshillit të përgjithëshëm rregullohen me akt të veçantë, që miratohet nga Kuvendi i degës.
- 16.4 Këshilli i përgjithëshum zgjedhë Kryesinë e degës, dhe mbikqyrë punën e kryesisë së degës, miraton dhe shqyrton raportet e kryesisë së degës.
- 16.5 Këshillin e përgjithëshëm e udhëheq kryetari i degës.

## **Neni 17**

### **Kryetari i Degës - Detyrat e Kryetarit të Degës**

17.1. Kryetari i Degës ka këto detyra:

- a. Përfaqëson anëtarësinë e PAI në territorin përkatës,
- b. Thërret dhe drejton mbledhjet e Kryesisë së Degës,
- c. Është përgjegjës për zbatimin e politikave të përgjithshme të PAI në nivel të Degës,
- d. Është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve të partisë në territorin përkatës,
- e. Së bashku me Kryesinë e Degës, për nevoja të PAI në degën përkatëse, krijon grupe ekspertësh për

çështje të caktuara profesionale, në të cilat mund të marrin pjesë edhe njerëz që nuk janë anëtarë degës , që të funksionin në mënyren më të mirë PAI në degë.

- f. Në kooFRinim me Kryesinë e Degës mbajnë aktive degën, duke mbajtur aktivitete, organizime, forume, tryeza edhe jashtë aktiviteteve të fushatës zgjedhore.
- g. Kryetari i Degës, për punën e tij, dy herë në vit është i obliguar t'i raportojë Kryetarit, Kryesisë PAI.

## **Neni 18**

### **Kryesia e Degës**

- 18.1. Kryesia e Degës udhëheq punën e partisë në degë, dhe zgjedhet nga Këshilli i përgjithëshëm i degës, kryesia degës duhet të ketë 9 – 15 Anëtarë.
- 18.2. Kryesia e Degës ka këto kompetenca:
  - a. Mobilizmin e strukturave të degës,
  - b. Organizimin e aktiviteteve partiake të degës,
  - c. Organizimin e procesit zgjedhor në degën përkatëse,
  - d. Një herë në vit i raporton me shkrim Këshillit përgjithëshëm të Degës për mbarëvajtjen e punëve të degës. Dhe veprimtarin e saj.

## **Neni 19**

### **Raportimi i degëve**

- 19.1. Kryesitë e degëve çdo tre muaj i dërgojnë raport me shkrim Kryesisë së PAI për mbarëvajtjen e punëve në degë, duke përfshirë gjendjen politike në degë, të hyrat dhe të dalat në degën përkatëse, aktivitetin dhe numrin e anëtarëve.
- 19.2. Kryesitë e nëndegëve çdo tre muaj i raportojnë Kryesisë dhe Këshillit përgjithëshëm të Degës përkatëse për gjendjen në nëndegët e tyre. Raporti dorëzohet në formë të shkruar.

## **Neni 20**

### **Situatat e jashtëzakonshme në funksionimin e degës**

- 20.1. Në rast të paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme dhe të mosmarrëveshjeve të cilat pamundësojnë funksionimin e degës përkatëse, Kryesia e PAI me vendim, pas konsultimit me Kryetarin PAI, mund ta shpërbëjë degën dhe të caktojë një udhëheqje të re të përkohshme deri në mbajtjen e kuvendit të jashtëzakonshëm në nivel të degës.

## **VI. ORGANET QENDRORE TË PAI-së**

### **Neni 21**

#### **Kuvendi Qendror**

- 21.1. Kuvendi Qendror i PAI-së është organi më i lartë.

- 22.2.Kuvendi qendror mbahet në sesione të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- 23.3.Kuvendi i rregullt i punës se Përgjithshme mund të jetë:
- a.Sesion pune,
  - b.Sesion zgjedhor.
- 23.3.Sesioni i punës së Kuvendit qendror mund të mbahet çdo dy vjet me vendim të këshillit të përgjithëshëm të PAI-së kurse ai zgjedhor çdo katër vjet ( 48 muaj ).
- 23.4.Sesionin zgjedhor e thërret Këshilli përgjithëshëm i cili cakton edhe datën e mbajtjes.
- 23.5 Kuvendi qendror nuk duhet të ketë pak se 131 delegat, duke përfshi gjitha degët e PAI-së, Numrin e delegatëve e përcakton këshilli i përgjithëshëm i PAI-së.

## **Neni 22**

### **Kompetencat e Kuvendit Qendror**

- 22.1. Miraton rendin e ditës,
- 22.2. Miraton Rregulloren e Punës,
- 22.3. Zgjedh Kryetarin e PAI.
- 22.4.Miraton Programin e PAI.
- 22.5. Miraton ndryshimet dhe plotësimet në Statut.
- 22.6. Miraton rezoluta,
- 22.7. Shqyrton raportin e punës dhe atë financiar të PAI midis dy kuvendeve,
- 22.8. Zgjedh Këshillin përgjithëshëm,
- 22.9. Shqyrton dhe merr vendime lidhur me ankesat dhe parashtresat, të cilat i paraqiten kuvendit.
- 22.10. Zgjedh Komisionin Statutar.

## **Neni 23**

### **Kryetari i PAI-së**

- 23.1.Kryetari është udhëheqës i PAI që përfaqëson unitetin e të gjithë anëtarëve të PAI.
- 23.2.Kryetari zgjedhet nga Kuvendi qendror i PAI-së në përputhje të nenit 22 të këtij Statuti.
- 23.3.Mandati i Kryetarit zgjat katër vjet ( 48 muaj).
- 23.4.Për punën e tij Kryetari i përgjigjet Kuvendit dhe Këshillit të përgjithëshëm.
- 23.5.Në rast mungese, apo pamundësie tjetër që Kryetari të ushtrojë detyrën, atë e zëvendëson nënkryetari i parë.

## **Neni 24**

### **Kryetari ka këto kompetenca:**

- 24.1.Përfaqëson PAI në organe vendore,
- 24.2.Përfaqëson PAI në organe dhe organizma ndërkombëtarë,
- 24.3.Udhëheq punën e organeve të PAI,
- 24.4.Thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kryesisë dhe të Këshillit Përgjithëshëm,
- 24.5.Propozon Nënkryetarin e parë, nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithëshëm të PAI,
- 24.6.Propozon komisione dhe trupa punues për fusha të ndryshëm,

- 24.7. Propozon përbërjen e delegacioneve të PAI për takime brenda dhe jashtë vendit,
- 24.8. Së bashku me Kryesinë jep propozimin përfundimtar për listën e kandidatëve të PAI në Parlamentin e Republikës së Kosovës.
- 24.9. Së bashku me Kryesinë jep propozimin përfundimtar për listën e kandidatëve për ministra, Zv. Ministra dhe pozita tjera qeveritare nga radhët e PAI.
- 24.10. Së bashku me Kryesinë, me akt të veçantë, propozon përjashtimin nga PAI e të gjithë atyre që veprojnë në kundërshtim me politikën e PAI dhe nuk i përmbahen disiplinës Statutore dhe partiake.
- 24.11. Propozon anëtarët shtesë në Kryesi.
- 24.12. Në konsultim me Kryesinë dhe Këshillin përgjithëshëm vendos të hyjë në koalicion para ose pas Zgjedhor.
- 24.13. Kryen punë të tjera, të parapara me Statut dhe rregullore.
- 24.14. Kryeson Kuvendin e partisë miniher, pas zgjedhjes së tij.
- 25.15 Kryetari PAI-së mund të përforr autoritetin e tij për të marrë vendim, në rastë kur Këshilli i përgjithëshëm, Kryesia ose Kryesit e degëve nuk gjejnë zgjidhje për një tem caktuar.

## **Këshilli i përgjithëshëm**

### **Neni 25**

- 25.1. Këshilli i përgjithëshëm është organi më i lartë i partisë në mes të dy konventave.
- 25.2. KP-ja i PAI ka 27 anëtarë dhe 1-3 anëtarë nga diaspora me .
- 25.3. Puna dhe funksionimi i KP-së rregullohen me akt të veçantë, që miratohet nga KP-ja.

Zgjedhja e anëtarëve të KP-së

### **Neni 26**

- 26.1. Anëtarët e KP-së zgjedhen në sesionin zgjedhor të Kuvendit të PAI-së, me mandat 4 vjeçar siç është përcaktuar në këtë statut.
- 26.2. Propozimin për anëtarë të KP-së mund ta bëjë secili kandidat në kubend, kryesia dhe kryetari i PAI.
- 26.3. Zgjedhja e anëtarëve të KP-së bëhet me votim të hapur.
- 26.4. Kandidatët e propozuar në listën finale të KP-së renditen në fletë sipas rendit alfabetik.
- 26.5. Në rast se ka dy ose më shumë kandidatë me vota të barabarta, vendoset me short.

## **Mbledhjet e KP-së dhe vendimmarrja**

### **Neni 27**

- 27.1. KP-ja mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- 27.2. Mbledhjet e rregullta të KP-së mbahen së paku një herë në tre muaj.
- 27.3. Mbledhjet e KP-së i thërret Kryetari, kryesia dhe 1/3 e anëtarëve të KP.

27.4.Për mbajtjen e mbledhjes së rregullt, anëtarët e KP-së duhet të njoftohen 7 ditë përpara. Për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të KP-së anëtarët duhet të njoftohen 2 ditë përpara.

275. Përveç anëtarëve, në mbledhjet e KP-së, me vendim të kryetarit dhe kryesisë mund të marrin pjesë kryetarët e degëve edhe kryetarët e komunave, të cilët nuk do të kenë të drejtë vote.

## **Humbja e statusit të anëtarit të KP-së dhe zëvendësimi**

### **Neni 28**

28.1.Statusi i të qenit anëtarë i KP-së të PAI humbet në këto raste:

a.Me dorëheqje,

b.Me vdekje,

c.Me përjashtim;

28.2. Vendimin për përjashtim e merr Keshilli Përgjithëshëm, pas konsultimit me organet kompetente statutore dhe vërtetimit për shkelje serioze të statutit dhe veprim në kundërshtim me politikat e PAI.

28.3. Zëvendësimi i anëtarëve të rinj të KP-së bëhet sipas propozimeve të degëve , dhe votohet nga anëtarët KP-së të PAI-së.

### **Neni 29**

#### **Kompetencat e KP-së janë:**

29.1.Jep propozimet për Program dhe Statut të PAI,

29. 2.Miraton Rregulloren për punën e vet dhe planin e punës,

29.3.Miraton rregullore tjera në kompetencën e vet, të përcaktuara me Statut,

29.4.Zgjedh anëtarët e Kryesisë,

29.5.Zgjedh komisione, këshilla dhe trupat punuese nga lëmenj të ndryshëm, ne pajtim me statutin,

29.6.Miraton llogarinë përfundimtare dhe buxhetin për vitin vijues,

29.7.Miraton Programin dhe Platformën Zgjedhore,

29.8.Zgjedh Shtabin Qendror Zgjedhor të PAI,

29.9.Krijon fondacione sipas nevojës së PAI-së,

29.10.Aprovon dhe rekomandon botime për nevoja të caktuara,për PAI-në

29.11.Jep çmime,

29.12.Kryen pune te tjera te përcaktuara me statut,

29.13.Miraton listën e kandidatëve për zgjedhje,

29.14.Vendos për lidhjen e koalicioneve para dhe pas zgjedhore.

## **Kryesia**

### **Neni 30**

1.Kryesia e PAI është organ ekzekutiv dhe menaxhues i PAI.

2.Kryesia i ka së paku 17 anëtarë,

Përbërja e kryesisë dhe mandati

### **Neni 31**

31.1.Kryesia përbëhet nga kryetari, nënkryetarët, sekretari i përgjithshëm, Arkatari, dhe anëtarët e tjerë.

2.Mandati i kryesisë është 4 vjeçar siç është përcaktuar në këtë statut.

## **Zgjedhja e anëtarëve të kryesisë**

### **Neni 32**

32.1. Anëtarët/et e kryesisë zgjedhen nga KP-ja me propozim të kryetarit të PAI.

32.2.Zgjedhja e anëtarëve të kryesisë bëhet me votim të hapur, përveqë se kur KP vendos ndryshe. Renditja e kandidatëve në fletëvotim bëhet sipas rendit alfabetik.

32.3 Konsiderohen të zgjedhur ata kandidatë që kanë fituar shumicën e votave.

32.4. Anëtarë sipas detyrës zyrtare të kryesisë me të drejtë vote janë edhe kryetari/ja e Forumit Gruasë dhe kryetari/ja e Forumit Rinisë.

## **Kompetencat e kryesisë**

### **Neni 33**

Kompetencat e kryesisë janë:

33.1. Së bashku me Kryetarin propozon listën e kandidatëve për zgjedhjet e nacionale dhe lokale, e cila i dorëzohet për miratim përfundimëtar KP, në bazë të këtij statuti.

33.2. Menaxhon të gjitha mjetet financiare dhe pasurinë tjetër në nivel qendror.

33.3. Kontrollon menaxhimin e pasurisë edhe ne nivele tjera te strukturave te PAI.

33.4. Në rast kontesti gjyqësor, personi i i autorizuar nga Kryesia përfaqëson PAI në procedurat gjyqësore dhe jo gjyqësore.

33.5. Angazhohet që çdo kryesi e degëve dhe e nëndegëve t'i përmbushë detyrimet e dhënies së llogarisë publike,

33.6. Jep pëlqimin për raportin përfundimtar financiar që miratohet nga KP,

33.7 Ka të drejtën e ndërhyrjes në politikat e degëve rast se ato bllokohen dhe në caktimin e kandidaturave në rast se kjo nuk bëhet nga ana e tyre.

33.8 Merrë vendimet me shumicë votave.

33.9 Cakton kriteret e përfaqësimit brenda strukturave të PAI dhe seleksionon kandidaturat për poste të larta,

33.10. Zgjedhë anëtarët e komisionit të kontrollit financiar, dhe komisioneve disiplinore,

33.11. Zgjedh udhëheqësin për Studime dhe Analiza , i cili propozohet nënkryetari për politika zhvillimore dhe publike,

33.12. Jep pëlqimin përfundimtarë për listën e kandidatëve të PAI për deputetë të Kuvendit të Kosovës,

33.13. Jep pëlqimin përfundimtarë për listën e kandidatëve për ministra,zv.ministra nga radhët e PAI,

33.14. Jep pëlqimin për kandidaturat e PAI për keretarë komune,

33.15. Themelon komisionin qendror disiplinor.

## **Mbledhjet dhe vendimmarrja e kryesisë**

### **Neni 34**

34.1. Kryesia mban mbledhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja mund të mbahet nëse janë prezent më shumë se gjysma e anëtarëve.

34.2. Mbledhjet e kryesisë udhëhiqen nga kryetari, në rast mungese të tij nga zëvendëskryetari, nënkryetarët ose sekretari.

34.3. Mbledhjet e rregullta mbahen ç'do dy javë,por jo ma larg se një muaj, dhe thirren nga kryetari dhe 1/3 e anëtarëve të kryesisë.

34.4. Mbledhjet e jashtëzakonshme mbahen në rast se kryetari apo 1/3 e anëtarëve e kërkojnë një gjë të tille.

34.5. Anëtarët e kryesisë për mbledhje të rregullta duhet të njoftohen 2 ditë përpara, kurse për ato të jashtëzakonshme 1 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes.

34.6. Vendimet në kryesi merren me shumicë votash. Në rast të votave të barabarta vendos vota e kryetarit të PAI.

## **Nënkryetarët**

### **Neni 35**

35.1. Nënkryetarët ushtron detyrat e kryetarit në rast mungese të tij.

35.2. Nënkryetarët ushtrojnë punët dhe detyrat të përcaktuara me rregulorën për ndarjen e përgjegjësiive të nënkryetëreve.

35.3. Për kryerjen e punës së tyre i raportojnë kryetarit dhe kryesisë së PAI.

## **Sekretari i përgjithshëm**

### **Neni 36**

36.1 .Sekretari i përgjithshëm i PAI kujdeset për organizimin dhe funksionimin e përgjithshëm të PAI dhe është udhëheqës i administratës së PAI si dhe është zyrtari më i lartë administrativ në PAI.

36.2. Kompetencat e Sekretarit të përgjithshëm janë:

- a. Organizon dhe udhëheq Zyrën Qendrore të PAI.
- b. Bashkë me nënkryetarin organizativë bën koordinimin e punëve me degët e PAI.
- c. Kujdeset dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Kryetarit, Kryesisë, Këshillit Drejtues dhe Komisioneve.
- d. Me pëlqimin e kryetarit të PAI i paraqet Kryesisë propozimin e vendimit për organizimin e Administratës Qendrore dhe kujdeset për ligshmërinë e punës së saj.
- e. Harmonizon punën e trupave të punës të PAI.
- f. Përgatitë dhe kujdeset për mbarëvajtjen e takimeve të organeve të PAI Ndhmon kryetarët/et e organeve të partisë në thirrjen e mbledhjeve dhe organizimin e punës.
- g. Kryen edhe punë tjera në harmoni me Statutin e PAI dhe punë të cilat i besohen nga kryetari dhe organet ekzekutive të Partisë.
- h. Mban kontakte të rregullta me KQZ-në.

### **Neni 37**

#### **Komisioni për Burime Njerëzore-KBN**

37.1. Në kuadër të kryesisë së PAI funksionon komisioni për burime njerëzore, që ka për qëllim udhëheqjen e politikës kadrovike brenda PAI.

37.2. KBN udhëhiqet nga nënkryetari i PAI dhe ka në përbërjen e tij nënkryetarët, sekretarin.

37.3. Kompetencat e KBN-së janë:

- a.I propozon kryesisë kandidaturat për anëtarë të Qeverisë,
- b.I propozon kryesisë listën e kandidatëve për deputetë të kuvendit të Republikës së Kosovës,
- c.I propozon kryesisë listën e kandidatëve për kryetarë të komunave,
- d.I propozon kryesisë anëtarë të tjerë në funksione shtetërore dhe funksione të tjera publike.



## **Grupi parlamentar**

### **Neni 38**

38.1. Grupi parlamentar i PAI përbëhet nga deputetët që përfaqësojnë PAI-në në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

38.2. Grupi parlamentar përfaqëson dhe mbron platformën e PAI në kuvendin e Republikës së Kosovës.

38.3. Vendos për ndarjen e deputetëve të PAI në komisionet e kuvendit.

38.4. Deputetet e PAI janë të detyruar të zbatojnë vendimet e GP dhe të Kryesise se PAI.

38.5. Puna dhe organizimi i GP përcaktohet me rregullore të veçantë.

## **Kapitulli VII**

### **Organet tjera të PAI**

#### **Neni 39**

1.Organet e tjera të PAI janë:

a.Komisioni i Kontrollit Financiar,

b.Forumi i Rinisë,

c.Forumi i Gruasë,

d.Komisionet disiplinore,

e.Komisioni statutar,

f.Instituti për studime dhe analiza

g.Kolegjiumi i kryetarëve të degëve

h. Kolegjiumi i ekspertëve,

i. Kabineti i kryetarit,

j. Shtabi Qendror Zgjedhor;

k.Grupet e përkrahësve të PAI”.

Dhe, Komisioni i Kontrollit Financiar.

#### **Neni 40**

40.1 Për kontrollin e aspekteve financiare të të gjithave strukturave drejtuese dhe të sektorëve të administratës të PAI, si dhe për shqyrtimin e ankesave, Konventa e përgjithshme zgjedh komisionin e kontrollit sipas këtij statuti.

40.2 Në rast të konfliktit të interesit të ndonjë anëtarë të Komisionit, i njëjti nuk mund të merr pjesë në shqyrtimin e çështjes së caktuar.

40.3 Zgjedhja e anëtarëve të Komisionit të kontrollit bëhet me votime të fshehta të shumicës së të pranishmëve.

40.4 Në rast të numrit të njëjtë të votave, vendoset me short.

40.5 Për drejtimin e punës, Komisioni i Kontrollit zgjedh Kryetarin nga radhët e veta.

40.6 Kontrolli behet të paktën një herë në vit dhe sipas nevojës.

40.7 Të gjitha dërgesat për Komisionin e kontrollit i drejtohen kryetarit të Komisionit,

40.8 Me kërkesën e Komisionit të Kontrollit apo të Kryesisë, mund të mbahen mbledhje të përbashkëta.

40.9 Komisioni i Kontrollit është i obliguar t'i kryejë detyrat e revizionit sipas Rregullores mbi Afarizmin Financiar të PAI-së, e cila nxjerrët nga KP.

40.10 Kujdeset për proceset e auditimit të buxhetit të partise dhe ndermer masa për zbatimin e rekomantimeve të raporteve vjetore të auditimit.

## **Forumi i Rinisë dhe Forumi i Gruasë**

### **Neni 40**

40.1 Si organe të PAI funksionojnë edhe FR dhe FG të cilët kanë për qëllim të Promovojnë idetë, vlerat dhe vizionin e PAI në grupet shoqërore në të cilat veprojnë.

40.2 Puna e FR dhe FG rregullohet me rregullore të veçanta të ndara, të cilat miratohen nga kryesia e PAI.

## **Komisionet disiplinore**

### **Neni 41**

41.1 Komisionet e disiplinore formohen në qendër nga kryesia e PAI dhe nëpër degë nga kryesia e degës për zgjedhjen e kontesteve.

41.2 Anëtarët e Komisionit Disiplinor zgjedhën nga kryesia qendrore dhe kryesia e degës për komisionet e degëve përkatëse.

41.3 Fushëveprimi dhe procedura e Komisionit të Disiplinor përkatës rregullohet me rregullore të veçantë, të cilën e nxjerr kryesia.

41.4 Për raste të veqanta themelohen më shumë komisione, kompetencat e të cilave vlejnjë për raste të caktuara.

41.5 Në Komisionin disiplinor përkatës zgjedhet një kryetar, një zëvendëskryetar dhe katër anëtarë.

## **Komisioni Statutar**

## **Neni 42**

42.1 Komisioni statutar është organi përfundimtar për interpretimin e statutit të PAI.

42.2 Vendimi i komisionit statutar për interpretim të statutit është përfundimtarë.

42.3 Anëtarët e komisionit statutar që janë 7 zgjedhën nga KP, me votim të fshehtë, pas propozimit të listës përfundimtare e cila bëhet nga KP.

42.4 Komisioni statutar merr vendime me shumicë të thjeshtë dhe mban mbledhje, sipas nevojës dhe pas paraqitjes së rasteve për interpretim të statutit.

42.5. Mënyra e punës dhe procedurat e të funksionimit të këtij komisioni rregullohen me vendim të veçantë i cili nxjerrët nga KP.

## **Instituti për Studime dhe Analiza**

### **Neni 43**

43.1 ISA është organ brenda PAI i cili merret me studime dhe analiza politike për nevoja të PAI.

43.2 Fushëveprimin dhe punën e ISA e mbikëqyrë dhe udheheqë nenkryetari për politika zhvillimore dhe publike.

43.3 ISA është e obliguar që të organizojë forume, tryeza, debate, trajnime, konferenca, të paraqesë studime dhe bëjë hulumtime për gjendjen politike, qeverisjen dhe aspektet e tjera dhe të njëjtat ti vejë në shërbim të PAI.

43.4 ISA udhëhiqet nga drejtori/ja i saj i cili emërohet nga kryesia me vendim të veçantë.

43.5 PAI do të angazhojnë në ISA edhe ekspertë që nuk janë anëtarë të PAI.

43.6 Angazhimi administratës në ISA, mënyra e punës dhe detajet e tjera, rregullohen me vendim të veçantë i cili nxjerrët nga kryesia e PAI.

43.7 Përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve në baza ditore të ISA është drejtori/ja i saj.

## **Kolegjiumi i kryetarëve të degëve-KKP**

### **Neni 44**

44.1 KKP është organ këshillëdhënës i cili përbëhet nga kryetarët e të gjitha degëve të PAI.

44.2 KKP angazhohet që të unifikojë dhe koFRinoj politikën e degëve të PAI.

44.3 KKP mban takime të rregullta ç' do muaji rendin e ditës për mbledhje e përcakton Kryesia e PAI.

44.4 Mbledhjet e KKP i thërret dhe i kryeson nënkryetari organizativ dhe sekretari i përgjithëshem i PAI.

44.5 Për punën e saj KKP i raporton kryesisë së PAI përmes sekretarit të saj.

## **Neni 45**

### **Kabineti i Kryetarit**

- 1.Gjatë kohës në veprim , PAI krijon kabinetin e kryetarit .
- 2.Puna e këtij organi përcaktohet me rregullore të veçantë e cila nxjerrët nga KP-ja.

## **Neni 46**

### **Shtabi qendror zgjedhor**

- 46.1 Shtabi qendror zgjedhor zgjedhët nga Kryesia e PAI.
- 46.2 htabi qendror zgjedhor udhëheq të gjitha veprimet elektorale për zgjedhjet lokale dhe ato të nacionale.
- 46.3 Puna e shtabit zgjedhor udhëheqet nga njëri prej anëtarëve të kryesisë.
- 46.4 Puna, organizimi dhe fushëveprimi i Shtabit qendror zgjedhor përcaktohet me rregullore të veçante. Grupet e përkrahësve të PAI.

## **Neni 47**

- 47.1 PAI ka grupet e vullnetarëve që përbëhen nga simpatizantët anëtarë dhe jo anarë të saj të cilat veprojnë në funksion të realizimit të qëllimit dhe vizionit të PAI.
- 47.2 Përmes punës së tyre grupet e vullnetërëve të PAI, angazhohen në dinamizmin dhe funksionalizimin e aktiviteteve të PAI në baza ditore.
- 47.3 Grupet e vullnetarëve funksionojnë nën mbikëqyrjen e nënkryetarit për politika zhvillimore dhe publike.
- 47.4 Mënyra e punës dhe aktivitetet e grupëve vullnetare i përcakton nënkryetari për politika zhvillimore dhe publike, në kuadër të fushëveprimtarisë së tij të përcaktuar me rregullore të veqantë.

## **Kapitulli VIII**

### **Disiplina partiake dhe mënyra e votimit**

## **Neni 48**

- 48.1 Të gjithë anëtarët e PAI, përfshirë edhe ata që janë në pozita të larta udhëheqëse brenda PAI, të cilët shkelin statutin, vendimet e organeve të PAI, programin, devijojnë nga politika e PAI ose në ndonjë formë tjetër shkelin parimet dhe vlerat e PAI, ndaj tyre shqiptohen masa disiplinore.
- 48.2 Në rast të vërtetimit të ndonjërës prej shkeljeve nga pika 1 merren këto masa disiplinore:
  - a.Vërejtja verbale,
  - b.Qortimi,
  - c.Marrja e përkohshme e funksionit,
  - d.Marrja e funksionit,

e.Përjashtimi i përkohshëm nga PAI,

f.Përjashtimi nga PAI.

## **Procedura disiplinore**

### **Neni 49**

49.1 Procedurën disiplinore ndaj çdo anëtari apo anëtare që është në pozita udhëheqëse të PAI iniciohet nga ana e secilit organ të PAI i cili e ka vërejtur shkeljen disiplinore.

49.2 Rastin për shkelje disiplinore e shqyrton komisioni qendror disiplinor ose komisionet disiplinore të degëve, të cilët brenda 15 ditësh nga momenti i pranimit të kërkesës duhet të vendosë për rastin.

49.3 Nëse pala përkatëse nuk është e kënaqur me vendimin, brenda afatit prej 15 ditësh vendimin e komisionit qendror disiplinor ose komisioneve të degëve vendimin mund ta apelojë pranë komisionit statutar.

49.4 Vendimin e marrë nga komisioni statutar mund ta ndryshojë vetëm konventa e përgjithshme e PAI.

49.5 Kryetari së bashku me kryesinë e PAI, me vendim të veçantë, jashtë procedurave disiplinore, mund të përjashtojnë nga PAI secilin zyrtar që është në funksione të larta në PAI, qeveri ose kuvend, nëse konsiderojë se ai vepron në kundërshtim me politikat e PAI.

49.6 Procedura dhe shqyrtimi disiplinor rregullohet me akt të veçantë i cili miratohet nga KP.

## **Procesi zgjedhor dhe financimi i PAI**

Procesi zgjedhor

### **Neni 50**

50.1 Zgjedhjet në PAI i shpall KP.

50.2 KP, me qëllim të organizimit sa më të mirë të zgjedhjeve cakton koordinator të procesit zgjedhorë njërin prej nënkryetarëve të saj.

50.3 Të gjitha organet e PAI i nënshtrohen procesit zgjedhor çdo katër vite.

50.4 Zgjedhjet mbahen në raunde të ndara, fillimisht për organet lokale, pastaj për ato qendrore dhe organet e tjera, siç është paraparë me këtë statut.

50.5 Në rast se në cilindo organ të PAI-së, kandidat potencial kanë vota të barabarta, atëherë fati i tyre vendoset me short. Shorti është publik dhe transparent, si dhe zhvillohet pranë organit përkatës.

50.6 Në rast të pretendimeve dhe ankesave për parregullsi në procesin zgjedhor të PAI-së, vendos komisioni statutar i PAI-së.

50.7 Pas perfundimit të zgjedhjeve në nivel lokal dhe atë qendror në afat prej 45 diteve duhet të zgjedhen të gjitha organet e parapara me këtë statut.

50.8 Të gjitha aspektet e tjera që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor në PAI, parashihen me një rregullore të veçantë e cila miratohet nga KP-ja, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me statut.

## **Financimi dhe kompensimet**

### **Neni 51**

51.1 PAI-ja financohet nga:

a.Mjetet e mbledhura nga anëtarësia e PAI-së,

b.Buxheti i Republikës së Kosovës, sipas ligjit në fuqi për financimin e subjekteve polike.

c.Donacionet nga donatorë të ndryshëm.

52.2 Raportet financiare dhe mënyra e financimit bëhen publike për anëtarët e KP dhe kryesisë. Raporti përfundimtarë për financimin e PAI miratohet nga kryesia qendrore. Kompetent për të kontrolluar financat e PAI është komisioni i kontrollit financiar siç është përcaktuar me këtë statut.

52.3 Mënyra, kushtet dhe aspektet tjera të kompensimit brenda PAI, caktohen me vendim të veçantë që e nxjerr kryesia qendrore.

52.4 Adminsitrimin e buxhetit të PAI e ben Kryetari dhe Arkatari PAI, i cili e njofton kryesinë e PAI për gjendjen financiare q’do 3 muaj.

## **Dispozitat e tjera**

### **Informimi**

### **Neni 53**

53.1 Anëtarët e PAI kanë të drejtë të informohen në mënyrë objektive dhe me kohë për vendimet e të gjitha organeve drejtuese.

53.2 Informimi i anëtarëve të PAI bëhet nëpërmjet formave te brendshme të informimit si dhe organit të PAI-së, në të cilin publikohen vendimet, qëndrimet, të marra nga organet drejtuese në të gjitha nivelet.

53.3 Është obligim i Degëve të PAI që në afat prej tri ditësh ta informojnë Zyrën Qendrore te Informimit dhe Redaksinë e organit për vendimet e marra nga seksionet dhe nëndegët.

53.4 Çështja e organizimit dhe funksionimit te informimit rregullohen me Rregulloren për Informim, të cilën e miraton Këshilli përgjithëshëm.

53.5 PAI informimin e zhvillon permes Mediave,Web faqës të PAI-së dhe formave tjera rrjeteve sociale.

## **Shërbimi administrativ**

### **Neni 54**

54.1 Për punët e përditshme PAI-ja angazhon staf administrativ, si në qendër ashtu edhe në nivel lokal.

54.2 Angazhimi paragrafi 1, si dhe mënyrat e kompensimit, bëhen nga kryesia e PAI, varësisht nga mundësitë buxhetore.

## **Detyrimet pasurore**

### **Neni 55**

55.1 PAI-ja nuk mund të marrë përsipër detyrime, sipas të cilave anëtarët e saj të përgjigjen me pasuri personale.

55.2 Për detyrime ligjore të PAI, përgjegjëse është vetëm ajo.

## **Dokumentimi i vendimeve**

### **Neni 56**

56.1 Të gjitha vendimet e organeve të PAI protokolohen dhe arkivohen në arkivën e PAI.

### **Neni 57**

## **Dispozitat përfundimtare**

Amendamenti i statutit

57.1 Amendamenti i statutit mund të bëhet nga Kuvendi i Përgjithshme e PAI, me 2/3 e votave të saj.

57.2. Propozues të amendamenteve në statut janë:

a. Kryetari,

b. Kryesia,

c. KP-ja,

d. 1/3 e anëtarëve të kuvendit,

e. Komisioni Statutar.

## **Interpretimi i statutit**

### **Neni 58**

58.1 Në rast se paraqitet vështirësi në zbatimin në praktikë të një dispozite të statutit, interpretimi i komisionit statutar është përfundimtar dhe i obligueshëm për të gjitha organet e PAI.

## **Tranzicioni dhe rregulloret e reja**

### **Neni 60**

60.1 Në bazë të këtij statuti, themelohen organet e reja dhe bëhet bartja e kompetencave dhe riorganizimi i organeve të PAI-së.

60.2 Kryesia e PAI cakton një komision ad hoc, për hartimin e rregulloreve të reja që dalin pas miratimit të statutit të ri.

60.3 Tranzicioni i organeve dhe hartimi i rregulloreve duhet të bëhet në së largu në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti.

60.4 Obligohet kryesia e PAI që brenda 30 ditëve të botojë tekstin origjinal të statutit dhe ta publikojë atë.

## **Hyrja në fuqi**

### **Neni 61**

61.1 Ky statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi qendror i PAI-së, dhe nënshkrimi i Kryetarit të PAI-së.

61.2. Ky statut është miratuar nga Kuvendi i tretë i PAI-së më 13.MAJ.2018. Prishtinë.

61.3 Ky statut duhet të vulozet nga vulja qendrore e PAI-së.

61.4. Këtë statut hynë në fuqi me nënshkrimin e Kryetari i PAI-së z.Etem Arifi \_\_\_\_\_